



Prishtinë, 05 qershor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1160_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084),dhe
- Nenin 6, 7, 8 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme të Energjisë,

në seancën e mbajtur me datë 05 qershor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **PEZULLOHET** – pranimi i aplikacioneve për marrje të autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për tu trajtuar si "**aplikacione në pritje**", dhe për tu përfshirë në Skemën Mbështetëse, jashtë caqeve të BRE-ve të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2017.
- II. Nga data **05.06.2019, ZRRE nuk do të pranon** asnjë aplikacion për marrje të autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për tu trajtuar si "**aplikacione në pritje**".
- III. Përgjashtimisht dispozitivit nën pikën I. dhe II., të këtij Vendimi, Vendimet për Autorizim Preliminar që janë lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të trajtohen sipas dispozitave ligjore të Rregullës për Skemën Mbështetëse.
- IV. Ky vendim vlen vetëm për rastet e aplikimit si "aplikacione në pritje", ndërsa për rastet tjera nuk do të zbatohet.

A r s y e t i m

- o ZRRE, kohët e fundit është duke u ballafaquar me numër të madh të aplikuesëve për marrje të autorizimit preliminar dhe përfshirje në skemën mbështetëse si "aplikacione në pritje", jashtë caqeve të disponueshme të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2017 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
- o Me Rregullën për Skemën Mbështetëse është paraparë mundësia që në momentin e plotësimit të caqeve të disponueshme, të aplikohet për marrjen e autorizimit preliminar sipas kërkesave të gjeneratorëve të BRE-ve, për hyrje në skemën mbështetëse, dhe ZRRE do të specifikojë në vendimet përkatëse se procesi për pranim në Skemën mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës për përcaktimin e caqeve, dhe këto aplikacione do të konsiderohen se aplikacione në "pritje".




- ZRRE, edhe përkundër informimit të aplikuesëve se ka pranuar/evidentuar disa aplikacione për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese ku kapaciteti i të cilave ka PËRMBUSHUR caqet për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE-të, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2017 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, aplikuesit kanë vazhduar me kompletimin e aplikacioneve për marrjen e Vendimit për Autorizim Preliminar, dhe të njëjtit janë përfshirë në listën e pritjes si “aplikacione në pritje”, sipas datës së lëshimit e Vendimit Preliminar.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të situatës aktuale dhe kërkesave të vazhdueshme të aplikuesve për përfshirje në skemën mbështetëse si “aplikacione në pritje”, ka vlerësuar se duhet të pezullohet pranimi i aplikacioneve shtesë për marrje të autorizimit për tu trajtuar si “aplikacione në pritje”, dhe për tu përfshirë në Skemën Mbështetëse jashtë caqeve të BRE-ve, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejrija, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Arkivit të ZRRE-së.